



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2022:281238
Datë: 27.12.2024
Numri i dokumentit: 06663220

K.DH.SH.II.nr.428/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Inspektorati Shëndetësor, me seli ne Prishtinë, Instituti B, kati për dhese, rrethi QKUK, kundër debitorit Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ne Podujevë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles e se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.118/23 dt.11.12.2023, me datën 27.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ne Podujevë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.118/23 dt.11.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles e se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.118/23 dt.11.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ne Podujevë, ndërsa urdhrin për lejimin e përmbartimit P.nr.174/2022 dt.10.11.2022 te Përmbartuesit Privat Isa Shala me seli ne Prishtinë e ka lënë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, pa përcaktuar bazat e veçanta ligjore, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë te aprovoj ankesën debitorit, aktvendimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Inspektorati Shëndetësor, me seli ne Prishtinë, Instituti B, kati përdhese, rrethi QKUK, me datën 09.11.2022, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ne Podujevë, në bazë të dokumentit përbarimor - Vendimit nr.10/D-001-20 dt.07.02.2020 i lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 22.07.2022. Përbaruesi Privat Isa Shala në Prishtinë, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përbarimor P.nr.174/22 dt.10.11.2022, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori qe ne emër te masës ndëshkimore, t'ia paguaj kreditorit shumen prej 5,000.00 euro, si edhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 15.12.2022, duke theksuar se dokumenti ne baze te cilit është lejuar përbarimi është ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP dhe atë nenin 27 par.1 dhe 36 te LPP, dhe arsyeton se ne momentin kur Inspektorati Shëndetësor ka shqiptuar dënim objekti Qendra kryesore e Mjekëses Familjare ka qenë ne renovim ne baze te kontratës nr.615-18-7210-5-2-1 dhe numër te brendshëm 123, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhri përbarimor ta shfuqizoj.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles e Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe provave ne lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.118/23 dt.11.12.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përbarimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka konstatuar se Vendimi nr.10/D-001-20 dt.07.02.2020, mbi bazën e te cilit është lejuar përbarimi është përcaktuar si dokument përbarimor me nenin 22 par.1 nenpar.1.2 te LPP, i njëjti përmban te gjitha elementet e përcaktuara me nenin 27 par.1 te LPP, dhe plotëson edhe kushtet ligjore nga neni 36 par.1 te LPP sepse është i pajisur me klauzolën e përbarueshmërisë sepse është bere i formës se prere dhe i ekzekutueshëm me datën 22.07.2022. Prandaj gjykata vlerësuar ketë gjendje faktike gjen se pretendimet e debitorit ne prapësim nuk paraqesin baze për anulim te urdhrin përbarimor ne kuptim te nenit 71 te LPP ndërsa ne mbështetje te nenit 73 te LPP vendosi jashtë seance.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 te LPK-së, as në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore me rastin e vendosjes. Edhe kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i lëshuar nga Inspektorati Shëndetësor,

është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 dhe nenin 27 paragraf 1 i LPP, pastaj një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me këtë dispozitë dhe se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ndërsa mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shiqim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi nr.10/D-001-20 dt.07.02.2020 mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga data 22.07.2022, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim. Ky dokument i plotëson të gjitha kushtet ligjore edhe nga neni 36 paragraf 1 të LPP - së, i cili parasheh që *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se *“ Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”*, e në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i cili propozimit për përmbarim i është bashkangjitur ne origjinal, ashtu që është i përshtatshëm për ekzekutim, andaj pretendimet e debitorit se dokumenti përmbarimor nuk përmban të gjitha elementet e pacaktuara me nenin 27 par.1 të LPP dhe nenit 36 të LPP kjo gjykatë i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, ashtu që si të tilla i refuzon ndërsa aktvendimin e atakuar të shkallës së parë e vërteton.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore, nën parimin e rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.428/24, me datë 27.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova